URDHËR
Nr. 375/2, datë 4.10.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 633 DATË 17.11.2020, "PËR NDALIMIN E GRUMBULLIMEVE NË VENDE TË MBYLLURA APO TË HAPURA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, të ligjit nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, si edhe në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 3926, prot., datë 22.9.2021,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 633, datë 17.11.2020, "Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura", të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 1 të urdhrit, togfjalëshi "deri më datë 4.10.2021", zëvendësohet me togfjalëshin "deri më datë 18.10.2021".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu